



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije

Nr. Prot. 029/B/12

VENDIM Nr. 193
për
Miratimin e Rregullores për
'Të drejtën e Shtegut dhe Shfrytëzimin e Përbashkët të Infrastrukturës'

Në mbështetje të neneve; nenit 4 paragrafi (4) dhe nenit 6, paragrafi (1) të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/7, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085 (tutje referuar si - Ligji); Pikave (3.6.2) dhe (3.6.3) të dokumentit mbi Politikën e Sektorit të Telekomunikacionit, Nr. 02/255, datë; 13 Qershor 2007, Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (tutje referuar si - ART), i përbërë nga,

- | | |
|----------------------|---------|
| 1) z. Ekrem Hoxha | Kryetar |
| 2) z. Besnik Berisha | Anëtar |
| 3) z. Lulzim Kurtaj | Anëtar |
| 4) z. Nijazi Ademaj | Anëtar |

në mbledhjen e XXXIII të Bordit të mbajtur më datë; 14 Mars, 2012, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ART-së, shqyrtoi dokumentet e përgatitura nga Departamenti i Telekomunikacionit me asistencën dhe mbikëqyrje profesionale nga ekspertët të Komisionit Evropian/TAIEX, për miratimin e **'Rregullores për të drejtën e shtegut dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës'**.

Nga diskutimi:

VËREHET se;

- Draft Rregullorja për 'Të drejtën për Shteg dhe Shfrytëzimin e Përbashkët të Infrastrukturës' është përgatitur në perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës nacional duke marrë në konsideratë të plotë direktivat, rekomandimet dhe praktikën e mira të shteteve të Bashkimit Evropian dhe nga shtetet e rajonit;
- Qëllimi i kësaj Rregullore është inkurajimi i shfrytëzimit efikas të infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturës tjetër të përshtatshme për shtrirjen dhe/ose akomodimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike me qëllim të zvogëlimit të kostos për shtrirje të rrjetave publike të komunikimeve elektronike;
- E drejta për të shfrytëzuar infrastrukturën në nivel nacional dhe komunal do të ju ofroj operatorëve mundësinë e shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi se sa në rastet kur infrastruktura nuk do të përdorej aty ku do të kishte mundësi;
- Përpara paraqitjes për miratim pranë Bordit drejtues të ART-së, draft rregullorja sipas aktvendimit Nr. 147 (Ref. ART Nr. Prot. 063/B/11) ka kaluar në procedurat adekuate të këshillimit publik, duke respektuar të gjitha afatet dhe procedurat ligjore;

- E gjitha kjo bëhet në funksion të promovimit dhe liberalizimit të tregut dhe krijimit të kushteve uniforme për të gjithë aktorët në këto tregje si dhe për hyrësit e potencial.

ATËHERË:

Me qëllim të;

- implementimit të dispozitave të Ligjit të Telekomunikacionit, ndërlidhur me promovimin e investimeve dhe konkurrencës së lirë në tregun e telekomunikimeve në Republikën e Kosovës;
- adaptimit dhe zbatimit të politikave, që synojnë të forcojnë liberalizimin e plotë dhe krijimin e një ambienti të hapur dhe konkurrent me qëllim të tërheqjes së investitorëve të huaj dhe përmirësimit të kualitetit të shërbimeve;
- shfrytëzimit efikas të Infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave tjera të përshtatshme për akomodimin e rrjetave të komunikimeve elektronike;
- sigurimin e një ambienti më të qëndrueshëm dhe konkurrues në tregun e komunikimeve elektronike;
- realizimit të zgjidhjeve, të cilat janë plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, direktivat dhe rekomandimet e BE-së, dhe praktikrat e mira të shteteve rajonale dhe ndërkombëtare.

Bordi i ART-së merr këtë,

V E N D I M:

- I. Miratimin e **'Rregullores për drejten e shtegut dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës'**, materialit bashkëngjitur këtij aktvendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i ART-së.

BAZA LIGJORE;

Vendimi, mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar;

- 1) Neni 1, paragrafi (1) dhe (2), neni 4 paragrafi (4), neni 6 paragrafi (1), neni 27 dhe neni 67 i Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-085;
- 2) Pikave (3.6.2) dhe (3.6.3) të dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të datës 13/06/2007;
- 3) Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE);
- 4) Neneve 11 dhe 12 të Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit evropian të datës; 07/03/2002 për krijimin e një kornize të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), e ndryshuar me Direktivën Nr. 2009/140/EC; dhe
- 5) Neneve 20 dhe 22 të Rregullores së Brendshme të ART.

Këshilla Juridike;

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vërtetim:

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtine, 20/03/2012

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Besnik Berisha	Anëtar i Bordit
Lulzim Kurtaj	Anëtar i Bordit
Nijazi Ademaj	Anëtar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve /Ofrueseve të Shërbimeve të Licencuar
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik
- Departamentit të Telekomunikacionit
- Arkivit të ART-së